

LIGJ
Nr.8433, datë 21.12.1998

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS TË
PRIVATIZIMIT TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE, SHA**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, të ligjit nr.8033, datë 16.11.1995 "Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe për lejimin e privatizimit të tyre" dhe të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Forma e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, Sha të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve të saj të tretëve, nëpërmjet shitjes, sipas formulës së privatizimit, të parashikuar në këtë ligj.

Neni 2

Formula e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, Sha të jetë si vijon:

1. Më shumë se 50 për qind e aksioneve do t'i transferohen nëpërmjet shitjes një investitori strategjik, me të cilin kuptohet një bankë, i cili do të zgjidhet nëpërmjet metodës së tenderit të hapur, ndërkombëtar.

2. Më pak se 50 për qind e aksioneve mund të ofrohen për shitje tek investitorët e tjerë, me të cilët kuptohen banka dhe institucione të tjera financiare, nëpërmjet negociatave. Kriteret për zhvillimin e negociatave caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Transferimi i së drejtës së pronësisë të aksioneve investitorëve, të parashikuar në nenin 2 të këtij ligji, do të bëhet vetëm me valutë.

Neni 4

Në rast se në përfundim të procedurave, sipas nenit 2 të këtij ligji, do të mbeten aksione të patransferuara investitorëve financiarë, pronari i tyre do të jetë shteti, i përfaqësuar me këtë cilësi nga Ministria e Financave.

Ministria e Financave ka të drejtë të negociojë me investitorët e zgjedhur, sipas nenit 2 të këtij ligji, për transferimin e pjesës së mbetur të aksioneve në pronësi të shtetit ose të vazhdojë procedurat ligjore për transferimin e tyre personave të tretë, jashtë shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit tregtar dhe bankar.

Neni 5

Investitorët që do të marrin pjesë në privatizimin dhe në blerjen e aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a. janë të detyruar të përmbushin të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe bankar i Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij ligji dhe për organizimin e procedurave të privatizimit, nëpërmjet shitjes së aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte normative në zbatim të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.2276, datë 22.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**